



NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE Nxitja e politikave të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë

#104

QSPA organizatore e konferencës ndërkombëtare “Gjuhët e rrezikuara dhe Diaspora”



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) zgjidhet zyrtarisht si institucioni pritës organizator i një prej konferencave më të rëndësishme ndërkombëtare nga Fondacioni për Gjuhët e Rrezikuara (FEL) me qendër në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kjo është një mundësi dhe vëmendje e posaçme për të shqyrtuar dhe diskutuar gjendjen dhe perspektivat për mbijetesën e dialekteve të shqipes jashtë vendit amë: të folmeve të arbëreshëve në Itali, në Kroaci, të arvanitasve, etj.

Kjo është një konferencë e rëndësishme që organizohet rregullisht çdo vit nga Fondacioni për Gjuhët e Rrezikuara (FEL) në bashkëpunim me universitetet dhe qendrat shkencore më të mira të botës.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

QBD/ “Tregime të moçme shqiptare” vijnë në botimin dygjuhësh shqip-greqisht


Qendra e Botimeve për Diasporë sjell falas online përkthimin e rrëfimeve më të dashura nga letërsia shqipe për fëmijë, me autor Mitrush Kutelin. Përrallat e “Tregimeve të moçme shqiptare” vijnë në botimin dygjuhësh shqip-greqisht, përkthyer nga Eleana Zhako dhe redaktuar nga Edlira Jorgaçi në gjuhën greke. Së shpejti dhe në shtyp. “Tregime të moçme shqiptare” është pjesë e projektit të botimeve dygjuhëshe, ndërmarrë nga QBD-ja. Dhjetë tregime të përzgjedhura nga vëllimi “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin, të përkthyer në pesë gjuhë: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Këto tregime dhe përralla do të shërbejnë për zgjerimin e njohurive, marrjen e informacionit dhe kultivimin e dijeve të nxënësve në Diasporë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën amtare. Ky botim shërben edhe si tekst ndihmës për shkollat në Diasporë, me qëllim thellimin e njohurive të tyre mbi gjuhën shqipe.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

QSPA/ Përkujtohet Giovanni Bellusio, poliedriku arbëresh i kohëve tona



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës organizuan sot veprimtarinë e radhës me temë: “Giovanni Bellusio, kontributi i poliedrikut arbëresh të kohëve tona”.

Takimi online synoi të nxjerrë në pah kontributin e shumëfishtë të këtij personaliteti të botës arbëreshe, me rastin 1-vjetorit të largimit të tij nga jeta. Në takim morën pjesë studiuesit e mirënjohur: Prof. Shezai Rrokaj, prof. Klara Kodra, Prof. Aljula Jubani dhe prof. Diana Kastrati.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

LIBRI/ “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3” falas online nga QBD

Qendra e Botimeve për Diasporën vë në dispozicion falas për shkollat shqipe në Diasporë tekstin shkollor “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3”. Teksti është hartuar në bazë të programit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, për fëmijët shqiptarë që jetojnë jashtë kësaj Republike dhe është teksti fitues i konkursit të shpallur nga kjo ministri, në vitin 2011. Me anë të tij, fëmijët shqiptarë do të mësojnë të shkruajnë dhe lexojnë shqip; do të mësojnë për historinë e trashëgiminë kulturore të shqiptarëve etj. Ky tekst vjen i rishikuar dhe i përmirësuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Dhuo Libra



Nisma “Dhuo libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)